

NJOFTIM

për

SHITJE TË PALUAJTSHMËRISË PRONË E TURKIYE İSBANKASI A.S. – DEGA NË KOSOVË

Turkiye Is Bankasi A.S. - Dega në Kosovë, njofton të gjithë të interesuarit se pranon oferta për shitje të paluajtshmërisë në pronësi të saj, me të dhënat si në vijim:

- | | |
|-------------------------------|------------------------------------------------------------|
| a) Numri i njësisë kadastrale | P-72514036-00589-138 me sipërfaqe prej 639m ² ; |
| b) Lloji i pronës | Pronë private; |
| c) Lloji i shfrytëzimit | Shtëpi dhe oborr; |
| d) Zona Kadastrale | Fushë Kosovë; |

Paluajtshmëria/ngastra kadastrale e lartpërmendur gjendet në Fushë-Kosovë dhe në të janë të ndërtuara dy ndërtesa, si në vijim:

Ndërtesa 1:

Kjo ndërtesë ka sipërfaqe të përgjithshme prej 832m² dhe është tip i ndërtimit P+3, ku garazha dhe kati përdhës janë të destinuara për biznes, ndërsa katet 1, 2 dhe 3 për banim.

Ndërtesa ka hyrje të veçantë në Rr. 17 Shkurti e njohur gjithashtu si Haxhi Zeka dhe ka këtë organizim:

- Kati përdhës përbëhet nga garazha dhe hapësira komerciale.
- Kati i parë përbëhet nga dy dhoma gjumi, një dhomë për qëndrim ditor, një banjo dhe një kuzhinë;
- Kati i dytë përbëhet nga dy dhoma gjumi, një dhomë për qëndrim ditor, një banjo dhe një kuzhinë; dhe
- Kati i tretë përbëhet nga dy dhoma gjumi, një dhomë për qëndrim ditor, një banjo dhe një kuzhinë.

Ndërtesa 2:

Kjo ndërtesë ka sipërfaqe të përgjithshme prej 360m² dhe është tip i ndërtimit P+3 ku kati përdhës është i destinuar për biznes dhe garazhë, ndërsa katet 1, 2 dhe 3 për banim. Ndërsa, prapa kësaj ndërtesë është edhe një hapësirë për depo me sipërfaqe prej 45m².

Ndërtesa ka hyrje të veçantë në Rr. Pajazit Islami dhe ka këtë organizim:

- Kati përdhës përbëhet nga garazha dhe hapësira komerciale;
- Kati i parë përbëhet nga një dhomë gjumi, një dhomë për qëndrim ditor, një banjo;
- Kati i dytë përbëhet nga një dhomë gjumi, një dhomë për qëndrim ditor bashkë me kuzhinë; dhe
- Kati i tretë përbëhet vetëm nga dy dhoma gjumi.

Të gjitha informatat shtesë lidhur me shitjen e paluajtshmërisë mund t'i merrni në Zyrën Qendrore të Turkiye Is Bankasi A.S. - Dega në Kosovë, përmes kërkesës me shkrim në e-mail adresën: procurement@isbank-kos.com dhe/apo në numrin e tel: +383 (0) 38 245 245.



Publikuar më 14.11.2019